



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës*  
*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke*  
*Ministry of Education and Science*

**TERMAT E REFERENCËS PËR**

**REKRUTIMI E**

**SPECIALISTIT TË PROKURIMIT PËR PROJEKTIN “EDUKIMI NË FËMIJËRINË E  
HERSHME DHE KUJDESI PËR KAPITALIN NJERËZOR”**

**ID E PROJEKTIT:** (P179656)

**EMRI I KREDISË:** PROJEKTI “EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME DHE KUJDESI  
PËR KAPITALIN NJERËZOR TË KOSOVËS”

**DATA:** 23 mars 2026

**HISTORIKU**

Projekti “Edukimi në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi për Kapitalin Njerëzor të Kosovës” është konceptuar për të avancuar prioritetet kryesore kombëtare në edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme (EKFH), përfshirjen sociale, barazinë gjinore dhe zhvillimin e ndërgjegjshëm ndaj klimës.

Në mënyrë specifike, Projekti fuqizon përpjekjet e Kosovës për të zgjeruar qasjen e barabartë në shërbime cilësore të EKFH-së, për të fuqizuar gratë dhe grupet e marginalizuara, për të forcuar kornizat institucionale dhe për të mbështetur zhvillimin në harmoni me klimën, në kuadër të prioritetëve strategjike si të Qeverisë, ashtu edhe të Bankës Botërore.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, qasja në shërbimet e EKFH-së mbetet e kufizuar dhe e pabarabartë në të gjithë vendin. Shkalla e regjistrimit të fëmijëve nën moshën pesëvjeçare është e ulët dhe, megjithëse pjesëmarrja në arsimin parashkollor (mosha 5–6 vjeç) është rritur, cilësia e shërbimeve dhe kohëzgjatja mbeten shqetësuese. Aty ku shërbimet ekzistojnë, ato karakterizohen nga ndryshueshmëria në standardet e infrastrukturës, kapacitetet e fuqisë punëtore, praktikat pedagogjike dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë. Këto sfida prekin në mënyrë joproporcionale fëmijët në zonat rurale dhe ata nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke i thelluar boshllëqet në mësimnxënie të hershme si dhe pabarazitë afatgjata. Si përgjigje, Qeveria e Kosovës, me mbështetjen e Bankës Botërore, është duke e zbatuar Projektin “Edukimi në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi për Kapitalin Njerëzor të Kosovës” (P179656). Objektivi i Zhvillimit të Projektit (OZHP) është përmirësimi i cilësisë dhe qasjes së barabartë në shërbimet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme në Kosovë. Projekti është i strukturuar rreth katër komponenteve që e përforcojnë njëra-tjetrën dhe që adresojnë kufizimet si në anën e ofertës, ashtu edhe në nivelin e sistemit në sektorin e EKFH-së.

**Komponenti 1: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të EKFH-së** fokusohet në forcimin e standardeve të shërbimit, avancimin e fuqisë punëtore të EKFH-së, përmirësimin e praktikave pedagogjike dhe fuqizimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë dhe monitorimit. Arritja e përmirësimeve të qëndrueshme në kuadër të këtij komponenti kërkon mbështetje analitike dhe asistencë teknike për të siguruar informata për kornizat e cilësisë të bazuara në dëshmi, strategjitë për zhvillimin e fuqisë punëtore dhe mjetet e zbatimit.

**Komponenti 2: Nxitja e integritetit multi-sektorial në ofrimin e shërbimeve të EKFH-së** trajton fragmentimin e shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme në sektorët e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve. Ndonëse Kosova ka bërë përparim në hartimin e politikave sektoriale, mekanizmat e koordinimit dhe kapaciteti zbatues mbeten të dobëta. Ky komponent e thekson nevojën për mbështetje teknike për të forcuar qeverisjen, qartësimin e roleve institucionale dhe funksionalizimin e modeleve të integruara të ofrimit të shërbimeve në nivel qendror dhe komunal.

**Komponenti 3: Rritja e qasjes së barabartë në shërbimet e EKFH-së** synon zgjerimin e disponueshmërisë së shërbimeve të EKFH-së, veçanërisht në komunat me mungesë të shërbimeve dhe për popullatat e cënueshme, përmes investimeve në infrastrukturë, zgjerimit të shërbimeve dhe masave të synuara për qasje. Nevojitet mbështetje analitike dhe këshilluese për të udhëzuar prioritetet, për të siguruar shënjestrim të fokusuar në barazi dhe për të mbështetur komunat në planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve për zgjerimin e qasjes në përputhje me realitetet demografike dhe fiskale.

**Komponenti 4: Menaxhimi i projektit dhe monitorimi e vlerësimi** mbështet zbatimin efektiv, koordinimin dhe monitorimin e rezultateve. Duke pasur parasysh kufizimet e kapaciteteve në sistemet e të dhënave, monitorimin e performancës dhe ciklet e të nxënies, kërkohet asistencë teknike e synuar për të forcuar kornizat e monitorimit dhe vlerësimit, për të mbështetur përdorimin e të dhënave administrative dhe anketuese dhe për të siguruar që përvoja nga zbatimi të reflektohet në politika dhe në vendimmarrjen operative.

Projekti zbatohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), e cila ka përgjegjësinë e përgjithshme për mbikëqyrjen strategjike, orientimin e politikave dhe koordinimin me ministritë përkatëse, ndërsa një Njësi e dedikuar për Zbatimin e Projektit (NJZP) në kuadër të MASH-it është përgjegjëse për menaxhimin e projektit në baza ditore, funksionet fiduciare, prokurimin, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe koordinimin e asistencës teknike në kuadër të komponenteve të projektit. Në këtë kuadër, projekti synon të themelojë Njësinë për Zbatimin e Projektit (NJZP) për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës dhe institucionet zbatuese në avancimin e projektit të EKFH-së në kuadër të secilit komponent të projektit, forcimin e gatishmërisë për zbatim dhe sigurimin që ndërhyrjet e projektit të përkthehen në përmirësime të matshme në cilësinë e shërbimeve, barazinë dhe rezultatet e kapitalit njerëzor.

Për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve që lidhen me prokurimin në kuadër të Projektit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në cilësinë e agjencisë zbatuese, synon të rekrutojë një Specialist të Prokurimit.

## **PËRGJEGJËSITË E SPECIALISTIT TË PROKURIMIT**

Specialisti i Prokurimit do të jetë përgjegjës për prokurimin efikas dhe me kohë të pakove të parapara në kuadër të projektit, duke përfshirë mallrat, punët dhe shërbimet teknike, si dhe për përzgjedhjen e shërbimeve të konsulencës, sipas dakordimit në Strategjinë e Prokurimit të Projektit për Zhvillim. Specialisti i Prokurimit do t'i raportojë ekipit menaxhues të NJZP-së. Specialisti i Prokurimit i raporton Koordinatorit të Projektit, duke punuar ngushtë me ekipin e NJZP-së dhe divizionin e prokurimit të MASH-it.

Funksionet kryesore të Specialistit të Prokurimit do të përfshijnë si në vijim:

- Të ndihmojë në planifikimin dhe zbatimin e Projektit, në përputhje me planin e dakorduar të prokurimit;
- Të ndihmojë Koordinatorin e Projektit në përgatitjen e buxhetit të Projektit, në përputhje me planin e dakorduar të prokurimit;
- Të përgatisë dhe përditësojë planet e prokurimit për zbatimin e Projektit sipas nevojës, duke përfshirë përditësimin e dokumentit të Strategjisë së Prokurimit të Projektit për Zhvillim;
- Të ndihmojë Koordinatorin e Projektit (dhe stafin tjetër të NJZP-së) në hartimin e Termave të Referencës për prokurimin e shërbimeve të konsulencës, në mbështetje të zbatimit të Projektit dhe në përputhje me Planin e Prokurimit;
- Të ndihmojë në hartimin e specifikimeve teknike, Termave të Referencës dhe vlerësimeve të kostos për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të konsulencës, në përputhje me Planin e Prokurimit;
- Të ofrojë mbështetje, sipas nevojës, për specialistët teknikë në zbatimin e komponenteve të Projektit lidhur me çështjet e prokurimit. Në rast të problemeve gjatë zbatimit të kontratës;

- Të ndihmojë Koordinatorin e Projektit dhe stafin e NJZP-së në analizimin e kërkesave kontraktuale, dispozitave të veçanta dhe specifikimeve teknike, si dhe të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve;
- Të ndihmojë Koordinatorin e Projektit dhe NJZP-në në negociata me furnizuesit dhe konsulentët për veprimet e nevojshme për përmirësimin e performancës dhe sigurimin e përfundimit të punës së tyre në përputhje me kushtet e përgjithshme e kontratave;
- Të mirëmbajë dhe përditësojë bazën e të dhënave dhe sistemin e monitorimit të prokurimit të Projektit përmes STEP-it;
- Të kryejë analiza vjetore të rezultateve të prokurimit për të identifikuar mundësitë për përmirësimin e cilësisë në procedurat e ardhshme të prokurimit dhe të përgatisë të dhëna për raportet e progresit të Projektit.
- Të ofrojë trajnim në vendin e punës për specialistët teknikë lidhur me çështjet e prokurimit që janë relevante për nevojat e tyre;
- Të forcojë kapacitetet e prokurimit të ekipit të Divizionit të Prokurimit të MASH-it;
- Në koordinim me Koordinatorin e Projektit, të hartojë korrespondencën lidhur me çështjet e prokurimit, e cila do t'i komunikohet Bankës;
- Të kontribuojë në përgatitjen e raporteve lidhur me çështjet e prokurimit të Projektit;
- Të mirëmbajë evidencën e prokurimit për të gjitha kontratat e nënshkruara në kuadër të Projektit, duke përfshirë edhe përmes STEP-it.

Në përgjithësi, detyrat specifike që do të ndërmerren nga konsulenti duhet të mbulojnë ciklin e plotë të prokurimit, të zbatueshëm për metodat e prokurimit të specifikuar në planin e prokurimit. Kjo do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në asistencë praktike për:

- Përgatitjen e dosjeve të tenderit (DT) për prokurimin e mallrave, punëve, shërbimeve jokonsulente dhe shërbimeve të konsulencës, të realizuara sipas metodave të prokurimit në përputhje me Planin e dakorduar të Prokurimit të Projektit (duke përfshirë dispozitat në PPSD) dhe dispozitat e Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore;
- Përgatitjen dhe publikimin e njoftimeve të prokurimit, sipas rastit, në kuadër të metodave të ndryshme të prokurimit;
- Ndihmën për NJZP-në në zhvillimin e procesit të tenderimit dhe përzgjedhjes, përfshirë takimet para-tenderuese ose para dorëzimit të propozimeve, sqarimet, hapjen e ofertave etj.;
- Shqyrtimin e hollësishëm të të gjithë dokumentacionit të tenderit, nga aspekti i prokurimit, para dorëzimit në Bankën Botërore, në kohën e duhur, për shqyrtim dhe moskundërshtim, në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore të përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë dhe në planin e dakorduar të prokurimit;
- Ndihmën për NJZP-në dhe Komisionin e Vlerësimit në përgatitjen e raporteve të vlerësimit duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të ofertave për furnizimin me mallra/punë, si dhe të propozimeve teknike dhe financiare për ofrimin e shërbimeve të konsulencës, sipas kërkesave të dokumenteve të tendert/kërkesës për propozime;

- Hartimin e listave të furnizuesve dhe kontraktorëve për blerje, si dhe listave të ngushta për pakot e konsulencës, duke marrë parasysh përvojën dhe kualifikimet e furnizuesve, kontraktorëve dhe konsulentëve;
- Ndihmën për NJZP-në në hartimin e kontratave dhe negociatat kontraktuale për furnizimin me mallra/punë dhe shërbime të konsulencës deri në nënshkrimin e kontratës, në përputhje të plotë me dispozitat e Rregulloreve të Prokurimit dhe Manualit të Operacioneve të Projektit;
- Kur është e nevojshme, në konsultim me Koordinatorin e Projektit, përshtatjen, modifikimin dhe ndryshimin e Specifikimeve Teknike të Kontratave për aktivitetet e projektit, përmes ndryshimeve të kontratës;
- Ndihmën për Koordinatorin e NJZP-së në sigurimin e dokumenteve përkatëse (siç janë fatura, pranimi i dorëzimit etj.) lidhur me pagesat sipas kontratave për furnizimin me mallra, punë dhe shërbime;
- Ndihmën për Koordinatorin e NJZP-së në dokumentet dhe procedurat për përfundimin e kontratës, si dhe raportimin përfundimtar;
- Çdo detyrë tjetër të kërkuar nga MASH-i dhe Koordinatorin e Projektit.

## **PERIUDHA E ANGAZHIMIT**

Specialisti i Prokurimit do të angazhohet me orar të plotë. Kontrata pritet të fillojë në maj 2026. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë një vit, me mundësi vazhdimi bazuar në performancë të kënaqshme dhe nevojat e projektit.

Konsulenti do të paguhet në baza mujore, sipas një tarife të dakorduar para nënshkrimit të kontratës. Të gjitha afatet dhe kushtet do të përshkruhen në kontratën e konsulentit. Kontrata do të jetë për Konsulent Individual sipas kontratës standarde të Bankës Botërore të bazuar në kohë, në përputhje me Rregulloret e Prokurimit të Bankës.

## **KUALIFIKIMET**

### **Kualifikimet e përgjithshme**

- Kualifikim pasuniversitar (*p.sh., MA ose më i lartë*) në financa, menaxhim, ekonomi, drejtësi, shkenca politike ose komunikim.
- Minimumi 5 vjet përvojë pune në prokurim.
- Përvojë e dëshmuar në projekte zhvillimore, përvoja paraprake në menaxhimin e projekteve të Bankës Botërore do të konsiderohet përparësi.
- Kërkohet njohje e gjuhës angleze dhe shqipe (njohja e gjuhës serbe është përparësi).

### **Kualifikimet specifike përkatëse për pozitën**

- Përvojë pune në projekte ndërkombëtare (të çfarëdo donatori), institucione qeveritare, kontrata të mëdha.

- Aftësi e dëshmuar për hartimin e pakove të prokurimit, TR-ve dhe raporteve të progresit në koordinim me Departamentin e Prokurimit të Ministrisë.

SHËNIM: Kandidati/ja i/e suksesshëm/me do të kërkohet të paraqesë dëshmi nga evidenca penale para konfirmimit përfundimtar të punësimit. Kjo pozitë i nënshtrohet verifikimit të kënaqshëm të historikut.

## **PROCEDURA E APLIKIMIT**

Të gjithë aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV
- Letër interesi
- Kopje të certifikatave dhe diplomave përkatëse
- Të dhënat e kontaktit për dy reference profesionale.

Dosja e plotë e aplikimit duhet të dorëzohet jo më vonë se më 31 mars, në orën 16:00, në adresën e mëposhtme të e-mailit: [apliko.mash@rks-gov.net](mailto:apliko.mash@rks-gov.net)

## **PROCESI I PËRZGJEDHJES**

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Kredimarrësit e Financimit të Projekteve Investive, korrik 2016, duke u bazuar në një thirrje të hapur.